

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**

Abteilung Volksschule

Sektion Schulaufsicht

*Zeitfenster Online-Befragung:
von 19 bis 28.3.2024*

Albanisch

KONTROLLI I CILËSISË KANTONALE NË SHKOLLËN FILLORE AARGAU

Informacion mbi sondazhin e prindërve

Të dashur prindër

Inspektorati i shkollës kantonale kryen kontrole çdo pesë vjet, në çdo shkollë të kantonit Aargau nëse përmbushen standardet e përcaktuara të cilësisë dhe nëse plotësohen kërkesat kantonale¹. Marrja në pyetje e prindërve është një pjesë e rëndësishme e kësaj procedure testuese. Ekziston mundësia që prindërit të pyeten për informacione shtesë në një datë të mëvonshme. Vëzhgimet kryhen në emër të inspektimit të shkollës nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Edukimit në Zvicrën Veriperëndimore.

Me këtë letër ju do të merrni një kod hyrjeje (TAN) për sondazhin në internet. Me këtë kod ju lidheni. Fjalëkalimet dhe emrat nuk janë të përcaktuara, kështu që anonimiteti juaj është i garantuar.

Do t'ju duhen rreth 20 minuta për t'ju përgjigjur pyetjeve. Ju mund t'i përgjigjeni pyetësorit online nëpërmjet internetit nga kompjuteri, tableti ose smartfoni juaj. Nëse keni disa fëmijë në shkollë, mund të plotësoni një ose më shumë pyetësor.

Hapat që duhen ndjekur:

- Ju duhet të hyni në adresën e internetit **www.vorbefragung.ch** (nëpërmjet një PC) ose mund të skanoni kodin QR (nëpërmjet Smartfonit ose Tabletit tuaj).
- Pastaj lidhuni me kodin tuaj në "**TAN / Losung**" me anë të kodit tuaj të hyrjes.
- Pyetësi shfaqet në gjuhën gjermane. Në menunë dropdown mund të zgjidhni njembëdhjetë gjuhë të tjera.
- Përgjigjuni pyetjeve brenda hapsirave të **Përcaktuara**.
- Përfundoni pyetësorin me "**Absenden**".

Inspektorati shkollor është shumë i interesuar mbi këndvështrimin tuaj dhe ju falënderon për pjesëmarrjen në anketim.

Përshëndetje të përzemërta

Schulaufsicht

sa.volksschule@ag.ch

¹ Për informacione shtesë hyni në <https://www.schulen-aargau.ch/regelschule/schulorganisation/qualitaet-aufsicht/kantonale-qualitaetskontrolle>